

2018: transporti intermodal, 875 mijë ton mallra me kamjonë në tragete

30 janar 2019



Kamjonët dhe trajlerët me targë shqiptare që kanë shfrytëzuar tragetet gjatë vitit 2018 kanë transportuar mbi 633 mijë ton mallra import-eksporti nga/drejt Durrësit. Shifra zë rreth 72 përqind të transportit të kryer me kamjonë dhe trajlerë, ndërsa pjesën e mbetur prej 242 mijë ton e zënë kamjonët dhe trajlerët me targa të huaja.

Sektori i Statistikave në APD, ka bërë të njohur këto ditë, të dhënat e transportit intermodal me automjete, të cilat pasi mbërrijnë në destinacionet portuale vijojnë udhëtimin rrugor drejt vendeve të tjera në Evropën Perëndimore apo në vendet e Ballkanit. Pjesa më e madhe e mallrave me kamjonë dhe trajlerë që transportohen me tragete me sistemin e transportit intermodal i përkasin linjës Bari-Durrës e kthim, me 354.588 ton gjithsej. 267.243 ton të tjera transportohen me kamjonë dhe trajlera përmes linjës Ankona – Durrës e kthim. 12 mijë ton gjithsej i janë drejtuar portit të Triestes, ose kanë mbërritur nga ky port në Durrës.

Në vitin që lamë pas në portin e Durrësit kanë mbërritur me tragete afro 40 mijë kamjonë dhe trajlera gjithsej, ndërsa janë larguar mbi 36 mijë të tjerë. Sipas specialistëve të sektorit të Statistikave, Transport Intermodal - është lëvizja e mallrave nga origjina në destinacion me disa mënyra transporti. Çdo mënyrë ka një ofrues të ndryshëm të transportit ose subjekte përgjegjëse, secili me kontratën e vet të pavarur. Transportuesit e shumtë janë kontraktuar për të përmbushur një udhëtim të vetëm.

